

VENDIM
Nr.680, datë 5.10.2011

**PËR MIRATIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË BORDIT TË
MENAXHIMIT PËR KONTROLLIN E BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK DHE TË
KOMITETIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 14 të ligjit nr.9720, datë 23.4.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të pikës 2 të nenit 28 të ligjit nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe të pikës 3 të nenit 4 të ligjit nr.10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Masa e shpërblimit të kryetarit dhe anëtarëve të Bordit të Menaxhimit për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik është, përkatësisht, 20 000 (njëzet mijë) lekë dhe 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë, për çdo pjesëmarrje në mbledhje, por jo më shumë se 4 (katër) herë në vit.

2. Masa e shpërblimit të anëtarëve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm është 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë, për çdo pjesëmarrje në mbledhje, por jo më shumë se 4 (katër) herë në vit.

3. Pika 1 e vendimit nr.548, datë 1.5.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të Komitetit të Auditimit të Brendshëm”, shfuqizohet.

4. Ngarkohet Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha